

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarve Sh. J, L. M, B.B, J. J dhe K. M me mbrojtësin me autorizim av..., për shkak të veprës penale Keqpërdorim i besimit nga neni 342 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2164/2016, të datës 22.12.2016, të cilën e përfaqësonte Prokurori Rozelida Hasani, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, mbi pranimin e marrëveshjes së fajësisë dhe të sanksionit penal, në prezencën e prokurorit, të akuzuarës, dhe mbrojtësit të saj më datën 14.07.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë,

A K T G J Y K I M

E Pandehura **K. M**, nga i ati M, e ëma Me, e lindur S. e lindur më dt...., në Gj, ku edhe jeton,...”, p.nr. e gjendjes së mesme ekonomike, punon si bankiere në Qendrën Tregtare “...e”, në Gjilan, shqiptare, shtetase e R. Kosovës, më parë e pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale.

Ë S H T Ë F A J T O R E

Sepse në muajin Korrik, Gusht dhe Shtator e deri më datë 08.10.2016, në kohë të pa përcaktuar, në rrugën Gjilan, e pandehura K. M- së bashku me të pandehurit Sh. J-bankier, L. M-menagjer i restorantit, B.B-bankier, dhe J. J-menaxher, të gjithë të punësuar Qendrën tregtarenë bashkëveprim dhe me planifikim paraprak kanë keqpërdorur besimin e të dëmtuarës....., në atë mënyrë që të pandehurit janë marr vesh mes vete ashtu që gjatë tre muajve korrik, gusht dhe shtator në restorantin e kësaj qendre përmes kamerierëve dhe bankierve të restorantit, me dijeninë e dy menagjerve kanë blerë kafe Milenium në ...me çmim prej ...euro për kg, të njëjtën fshehurazi e kanë sjellur në restorant dhe e kanë furnizua-mbushë aparatin e kafes, në vend të kafes me kualitet dhe çmim prej 18 euro që ka pasurnë dispozicion dhe me kafe të kualitetit të dobët i kanë shërbyer mysafirët, ndërsa nuk i kanë regjistruar në arkë fiskale si shitje dhe diferencën në çmim e kanë përfituar për vete, përpos kësaj të pandehurit që kanë punuar drejtë për drejtë Sh, B dhe K me dijeninë e menaxherëve të tyre-tani të pandehurit Ji dhe L, të njëjtit kanë bërë përzierjen e lëngjeve freskuese me ujë (Limonadë, bozë dhe boronicë) kanë shtuar vëllim sasior dhe këtë diferencë e kanë shitur pa kupona fiskal mysafirëve të ndryshëm dhe fitimin e kanë ndalë për vete, ndërsa njëjte kanë vepruar edhe me ëmbëlsira të cilët sasinë e dëmtuar apo me afat të skaduar ishte regjistruar shumëfish më shumë se sa që janë hedhur dhe fitimin nga shitja e pa regjistruar e kanë përvetësuar për vete, në këtë mënyrë të pandehurit nuk i kanë përmbushur detyrimet e tyre dhe e kanë keqpërdorur besimin e të dëmtuarës me qëllim që vetit ti sjellin përfitim të kundërligjshëm pasuror, duke i shkaktuar të dëmtuarës dëm material në vlerë të pa përcaktuar.

-me çka ka kryer veprën penale, Keqpërdorimi besimit nga neni 342 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-s.

Prandaj gjykata duke iu referuar marrëveshjes së arritur me shkrim mbi pranimin e fajësisë të akuzuarës Kaltrinë Musliu, në bazë të nenit 4, 41, 50, 51, 73 dhe 75 të KPRK-s dhe nenit 233 dhe 365 të KPPRK-s të pandehurës i shqipton:

DENIM ME KUSHT

Të pandehurës K. M, i shqiptohet dënim kumulativ me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditë, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse e pandehura në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër tjetër penale, mbikëqyrjen e dënimit të shqiptuar me kusht do ta bëjë Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjilan.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Të pandehurës i shqiptohet taksa për Kompenzimin e Viktimave të krimit në shumën prej 30 euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën par. 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të krimit. Obligohet e pandehura të paguaj shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzet) euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcnim të përmbarrimit të dhunshëm.

VEQOHET PROCEDURA PENALE ndaj të pandehurve Sh. J, L. M, B.B dhe J. J me vendbanim në Gjilan, për shkak të veprës penale Keqpërdorim i besimit nga neni 342 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-s, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2164/2016, të datës 22.12.2016 dhe në kuptim të paragrafit 3 të këtij neni, kundër aktvendimit nuk është lejuar ankesa.

A r s y e t i m

Kundër të akuzuarve në fjalë është ngritur akti akuzues lëndor për shkak të dyshimit të bazuar se të njejtit kanë kryer veprën penale lëndore të përshkruara më gjërë si në pikpamje faktike ashtu edhe juridike në vet aktin e tillë shkresor. Gjyqtari i vetëm gjykues ka caktuar shqyrtimin fillestar duke i ftuar palët dhe pjesëmarrësit tjerë në këtë qështje penale. Pasi që e pandehura Kaltrinë Musliu ka lidhur marveshje për pranimin e fajsisë me Prokurorinë, gjyqtari pas sigurimit të mendimit të palëvë, me aktvendim procedural ka veqar procedurën penale kundër të pandehurve Sh. Ji, L. M, B.B dhe J. J në kuptim të nenit 36 të KPP, e në kuptim të paragrafit 3, kundër aktvendimit nuk është lejuar ankesa.

Prokurori i shtetit Rozelida Hasani deklaroi: Pas negociimit për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, më dt. 30.06.2017, kemi arritur marrëveshje, mbi pranimin e fajësisë me të pandehurën..., ku e njëjta është pajtuar që të pranoj fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, e atë gjithnjë në pjesëmarrje dhe konsultim me mbrojtësin e saj. Prandaj, bazuar në këtë kërkojmë nga gjykata që konform nenit 233 par. 21 të KP që këtë marrëveshje dhe dënimin ta aprovojë.

Mbrojtësi i të pandehurës ...deklaroi: pas konsultimit të mjaftueshëm me të mbrojturën time dhe pas negociimit lidhur me arritjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë kemi arrit marrëveshje me PTH në Gjilan e përmes së cilës është rekomanduar edhe dënimi. Nga gjykata kërkojmë që me rastin e pranimit të kësaj marrëveshje të merr parasysh edhe rrethanat lehtësuese për të mbrojturën time siç janë pranimi i fajësisë, e njëjta është penduar dhe asnjëherë më parë nuk ka ra ndesh me ligjin. Andaj nga të cekurat më lartë i propozojmë gjykatës që këtë marrëveshje dhe dënimin ta pranojë duke qenë se e njëjta është lidhur në përputhmëni me dispozitat e KPP,

E pandehura..., deklaroi: e mbështes në tërësi deklaratën e mbrojtësit tim, më vie keq për rastin që ka ndodhur, i kërkoj falje të dëmtuarës dhe nuk kam tjetër çka të shtoj.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë përmbante të gjitha faktet duke bërë propozim për marrëveshjen e pranimit të fajësisë duke e njoftuar të pandehurën me të drejtat dhe pasojat e pranimit të fajësisë duke dhënë deklaratë me shkrim, se e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, të bërë në mënyrë vullnetare.

Gjykata ka gjetur se e pandehura ka bërë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal mbështetur në nenin 233 të KPPRK, dhe e njëjta marveshje ishte në përputhje me kushtet e parapara me pikën 12 të këtij neni.

Gjykata është vërtetuar se e pandehura e ka kryer veprën penale e cila i vëhet në barrë dhe ka konstatuar se nuk ekziston asnjë përjashtim si në nenin 248 të KPPRK.

Në seancën për pranimin e fajësisë përfaqësuesi i akuzës e pandehura dhe mbrojtësi i saj janë marr vesh edhe lidhur me sanksionin penal, ashtu që të pandehurës ti shqiptohet dënim kumulativ me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) euro dhe denim me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditë, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen, nëse e akuzuara në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti, duke filluar nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale. Të pandehurës i shqiptohet taksa për Kompenzimin e Viktimave të krimit në shumën prej 30 euro, konform nenit 39 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompenzimin e Viktimave të krimit dhe obligohet e akuzuara të paguaj shpenzimet e procedurës penale.

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Përfaqësuesi i akuzës, e pandehura dhe mbrojtësi i saj i caktuar sipas detyrës zyrtare kanë hequr dorë nga e drejta në ankesë. Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.1520/2016 të datës 14.07.2017

Sekretarja Juridike,
Naile Neziri d.v

Gjykatësi i vetëm gjykues,
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi pala e dëmtuar mund të paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate Themelore.